



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 dhjetor 2011  
Nr. ref.: RK176/11

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI 102/11**

Parashtruesja

**Shahe Ramaj**

kundër

**Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Shëndetësisë**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese është znj. Shahe Ramaj, me vendbanim në Tërdec, komuna e Gllgocit.

## **Objekti i çështjes**

2. Parashtruesja dorëzoi një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 28 korrik 2011. Ajo ankohet që Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria), Ministria e Shëndetësisë nuk e ka shpallur Ligjin për sigurimin shëndetësor.
3. Parashtruesja ankohet që Qeveria - Ministria e Shëndetësisë ka shkelur:
  - a. Nenin 21.1 dhe 3 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 24.1 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta);
  - b. Nenin 29 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut;
  - c. Nenin 1 [Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut] dhe nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj (në tekstin e mëtejme: KEDNJ); dhe
  - d. Nenin 2 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit (Nr. 03/L-121 i 15 janarit 2009) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 28 korrik 2011.
6. Më 17 gusht 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 102/11, e caktoi Zëvendëskryetarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 102/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.
7. Më 24 tetor 2011, Gjykata e njoftoi Ministrinë e Shëndetësisë për këtë kërkesë, e cila u përgjigj më 9 nëntor 2011 duke thënë që projektligji për sigurimin shëndetësor është përgatitur dhe që Ministria e Shëndetësisë është vetëm duke pritur vlerësimin e implikimeve buxhetore nga Ministria e Financave për t'ia proceduar Qeverisë projektligjin për sigurimin shëndetësor.
8. Më 29 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

9. Më 28 mars 2011, parashtruesja ngriti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Qeverisë, Ministrisë së Shëndetësisë, për shkak të mosshpalljes së Ligjit për sigurimin shëndetësor.
10. Më 29 prill 2011, parashtruesja dorëzoi një kërkesë në Gjykatën Komunale, me të cilën kërkonte shqyrtimin e padisë së saj.

11. Më 24 maj 2011, parashtruesja dorëzoi një parashtrësë në Gjykatën Komunale për modifikimin e padisë së saj.
12. Më 31 maj 2011, parashtruesja ushtroi ankesë në Inspektoratin Gjyqësor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK) kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë për shkak të dështimit për ta shqyrtuar dhe zgjidhur padinë e saj.
13. Më 8 qershor 2011, Zyra e Prokurorit Disiplinor (në tekstin e mëtejme: ZPD) e KGJK-së vendosi që kërkesa e parashtrueses është e parakohshme për shkak të faktit që ajo e kishte dorëzuar padinë e saj në Gjykatën Komunale vetëm më 28 mars 2011 (ZPD/11/kb/0472).
14. Më 13 qershor 2011, parashtruesja ushtroi ankesë në KGJK kundër vendimit të ZPD-së.

### **Pretendimet e parashtrueses**

15. Parashtruesja pohon që:
  - a. Deri më tani nuk ka marrë përgjigje as nga KGJK-ja as nga Gjykata Komunale në Prishtinë;
  - b. Qeveria, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë, ka shpallur shumë ligje, ndërsa Ligji për sigurimin shëndetësor nuk është shpallur;
  - c. Qeveria ka theksuar se nuk ka buxhet për shpalljen e këtij ligji, por kjo nuk është e vërtetë. Qeveria ka miratuar shumë ligje dhe ka ndarë buxhet për ndërtimin e shumë ndërtesave për strehim social në Kosovë, për ndërtimin e universiteteve në Kosovë dhe për magjistralen në Kosovë. Ajo ka fonde për gjithçka, por jo për Ligjin për sigurimin shëndetësor.
  - d. Me mosshpalljen e këtij ligji, Qeveria e Kosovës ka bërë diskriminimin më të madh të mundshëm që një vend mund t'ua bëjë qytetarëve të vet, posaçërisht kësaj kategorie.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

16. Parashtruesja pohon që Qeveria, Ministria e Shëndetësisë, ia ka shkelur të drejtat e garantuara me nenet 21.1 dhe 3 [Parimet e Përgjithshme] dhe 24.1 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, nenin 29 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, nenin 1 [Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut] dhe nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të KEDNJ-së, dhe nenin 2 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokolleve të saj, për shkak të mosshpalljes së Ligjit për sigurimin shëndetësor. Gjykata vëren që, për të gjykuar për ankesën e parashtrueses, ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili përcakton:

*"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."*

dhe nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
18. Prandaj, Gjykata thekson që Kushtetuta nuk parasheh “*actio popularis*”, d.m.th. individët nuk mund të ankohen në abstrakt për legjislacionin apo aktet e Qeverisë që nuk janë zbatuar personalisht në ta përmes një mase të zbatimit.
19. Nga dokumentet e dorëzuara, Gjykata vëren që ajo nuk ka argumentuar që një autoritet publik ia ka shkelur të drejtat individuale dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, siç përcaktohet në nenin 113.7 të Kushtetutës.
20. Prandaj, rezulton që kërkesa e parashtrueses duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të neneve 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese më 29 nëntor 2011, njëzëri

### VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Mr.Sc.Kadri Kryeziu

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



  
Prof. Dr. Enver Hasani